



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

9 korrik 2013

**Debat i organizuar nga Instituti për hulumtime  
gjeostrategjike dhe politik të jashtme pranë Ministrisë për  
punë të jashtme me rastin e anëtarësimit të Kroacisë në  
Bashkimin Evropian**

Fjalim  
Ambasador Aivo ORAV  
Shef i Delegacionit të Bashkimit Evropian

Z. Kryesues, Ministër, Ambasador i Kroacisë, zonja dhe zotëri,

Kemi shumë këtë muaj në BE arsye për të festuar – Kroacia më 1 korrik të vitit 2013 u bë anëtarja e 28-të e BE-së.

Kjo ditë do ta shënoj historinë e Kroacisë, historinë e BE-së dhe historinë e Evropës Juglindore

Kroacia u bë anëtare e BE-së – kjo nënkupton disa gjëra:

- gabuan ata që mendonin se zgjerimi i BE-së më së miri mund të përshkruhet me fjalët "lodhje nga zgjerimi "- Kroacia tregoi se zgjerimi vazhdon;
- anëtarësimi në BE është i mundur nëse ekziston një vullnet i fortë politik, dëshirë të vërtetë për reformim të vendit dhe përcjellje të standardeve politike.

Kroacia u bë anëtare e BE-së në kohëra ndoshta edhe jo aq të mira për Unionin – të paktën ka zëra që e mbronin këtë argument.

Ne mund ti dëgjojmë euroskeptikët të tillë si brenda ashtu edhe jashtë Bashkimit Evropian.

**Euroskeptikët** na tregojnë se ndikimi i BE-së mbi shtete e reja të BE-së është negativ.

Ti shohim argumentet më të shpeshta që përdoren kundër BE-së: rritja e çmimeve, burokraci më të madhe, dhe mbi të gjithash, se euroja do të shembet nesër.

**Rritja e çmimeve:** rritja e disa çmimeve është e pashmangshme kur një vend bëhet anëtarë i BE-së, siç është akciza e cigareve.

Por, nuk ka as një gjë të keqe nëse cigaret bëhen më të shtrenjta, rezultati është se njerëzit do të jetojnë më gjatë.

Shumë produkte mund të bëhen më të shtrenjta pasi që nuk do të ketë vend që kompanitë joefikase të gëzojnë ndihmës të konsiderueshme shtetërore.

Arsyeja është që të gjithë kompanitë të jenë në pozitë të barabartë me qëllim që të prodhojnë mallra më të mira dhe të ofrojnë shërbime për të mirën e qytetarëve të Bashkimit Evropian. Shembull i mirë për këtë janë çmimet për roaming të kompanive të telekomunikacionit të BE-së.

**Burokracia** – ky argument shpesh përdoret kundër Bashkimit Evropian.

Shtetet anëtare të BE-së i kanë themeluar institucionet e tyre, ku të gjithë 28 shtetet anëtare punojnë së bashku. Ky sistem është unik, ku njerëz me përkatësi të ndryshme etnike dhe kulturore punojnë së bashku dhe ndihmojnë që BE-ja të funksionoj në mënyrë më të mirë.

Francezët dhe gjermanët –armiq para 70 vite, punojnë si koleg së bashku për të realizuar objektiva të përbashkëta. Kjo është garanci më e mirë për të shmangur konfliktet me të cilat është përballë Evropa në të kaluarën.

Në fakt, kostoja për funksionim të institucioneve të BE-së, është më e ulët se 4% të buxhetit. Nuk ka shumë qeveri, nëse edhe ekzistojnë të tillë, që mund të prezantojnë numra të tilla.

**Më pakë pavarësi** – Euroskeptikët dëshirojnë të na tregojnë se nëse një vend i vogël anëtarësohet në BE, do të ketë më pakë pavarësi ose do ta humbas atë në tërësi.

Çdo vend, institucioneve të BE-së u jep një pjesë të pavarësisë – për zëvendësim bëhet pjesë të procesit vendimmarrës.

Kjo është mënyra se si BE-ja të veproj në mënyrë të përbashkët dhe ta ketë rolin e lojtarit global. Pa këtë, vetëm disa vende të Evropës do të mund ta kenë këtë rol.

Lidhjet të ngushta institucionale nuk do të lejojnë askënd që të lëvizë jashtë rrugës demokratike, ekonomisë së tregut, sundimit të ligjit dhe të drejtat e njeriut.

**Probleme ekonomike**– Po, ekzistojnë probleme ekonomike.

Por ana pozitive të problemeve të tilla është se vitet e fundit kanë treguar se sa mirë funksionon solidariteti në BE. Sigurisht

që ka zëra në shtetet anëtare të BE-së që thonë: kjo nuk mjafton për ne / ose kjo tashmë është shumë për ne.

Por, të gjithë qeveritë të shteteve anëtare të BE-së e kishin të qartë se të gjithë ne kemi përfituar nga solidariteti – dhe jo vetëm ata që kanë pranuar ndihmë financiare.

Sot jemi duke konsumuar shumë nga resurset e botës. Por, Agjenda Evropa 2020 është një përgjigje efikase për këtë dhe ne mund ta arrimë këtë në mënyrë të përbashkët.

**Euro** – është mjaft popullore të deklarohej se euroja do të zhduket shpejtë. Dhe këtë e dëgjojmë çdo ditë, 3 vite me radhë.

Euroja është valutë botërore dhe deklaratat se euroja do të zhduket është e njëjtë si deklarata se dollari ose jeni do të zhduken.

Eurozona rritet pothuajse çdo vjet. Më 1 janar të vitit 2012, Estonia e pranoi euron, ndërsa Letonia do ta pranojë atë vitin tjetër, dhe ky proces do të përcillet edhe nga: Polonia, nga Republika e Çekisë, Hungarisë, Lituanisë, Bullgarisë, Rumanisë dhe Kroacisë. Dhe pse jo edhe nga Suedia, nga Britania e Madhe, Danimarka?

Këto janë argumentet kryesore që i shfrytëzojnë Euroskeptikët kundër Bashkimit Evropian.

Zonja dhe zotëri,

Javën e kaluar isha i inkurajuar nga shumë njerëz që të vazhdojë me promovim të vlerave, qëllimeve dhe përfitimeve nga Bashkimi Evropian, edhe pse jo të gjithë shtetet të rajonit morën mesazhe të mira nga takimi i fundit i Këshillat Evropiane.

Pajtohem se kjo është e nevojshme, por, në të njëjtën kohë, jam i bindur se përfitimet nga Bashkimi Evropian njihen mirë nga qytetarët e vendit.

Të përmendi vetëm 3:

**1. Lëvizje e lirë e punës, mallrave dhe kapitalit** – është diçka që mund të shfrytëzohet nga të gjithë.

**2. Paqe** – diçka që nuk e vërejmë nëse e kemi.

Jeta pa luftëra na mundëson parashikueshmëri dhe siguri për të jetuar në mënyrë sa më të mirë.

**3. Demokraci, sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut** – për këto vlera shumë njerëz në botë janë duke luftuar.

Ne i kemi këto vlera në Bashkimin Evropian. Dhe shpresojmë se shumë e më shumë shtete do ti përcjellin këto vlera, sidomos në suaza të kufijve tona.

**Ti kthehemi zgjerimit të BE-së.**

Dua të përmendi se para 20 vjet askush në Paris, Berlin, Uashington, Moskë ose në Vilnius nuk ka besuar se Lituania mund të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian.

Sot Lituania kryeson me bashkimin Evropian në suaza të rotacionit për kryesim me BE-në.

Ndërsa Kroacia sot është anëtare.

Kjo do të thotë se zgjerimi i BE-së ka ndodhur në mënyrë që i ka tejkaluar të gjitha vizionet dhe pritjet të politikbërësve të së kaluarës.

Kjo është një lajm i mirë për shtetet që akoma janë jashtë, por i trokasin derës së BE-së.

Shpresojmë se Kroacia është maksimalisht e përgatitur për ti ndërmarrë obligimet dhe ti gëzoj përfitimet të Bashkimit Evropian nga vetë fillimi i anëtarësimit.

Tani Kroacia është pjesë e procesit të vendimmarrjes në BE.

Kroacia ndihmon që të ndërtohet konsensus në Bashkimin Evropian për çështjet e brendshme të BE-së si dhe për marrëdhëniet e jashtme.

Kroacia vjen nga Evropa Juglindore – kjo do të thotë se tani kemi shumë më tepër njohuri për rajonin. Shpresojmë se koj do të thotë se interesi i rajonit do të mbulohet akoma më mirë.

Kroacia ka kaluar çaste të vështira gjatë negociatave me BE-në. Ajo ka njohuri më të mira dhe më të freskëta sa i përket negociatave. Shtetet tjera aspiruese tani kanë mundësi të shkëlqyer të mësojnë nga eksperiencia kroate.

Siç thash në fillim: zgjerimi i BE-së vazhdon dhe nuk do të përfundoj deri sa të gjitha shtetet e rajonit nuk bëhen anëtare të Bashkimit Evropian.